



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 556/6 Prot.

Tiranë, më 27.12.2016

**V E N D I M**

Nr. 166, datë 27/ 12/2016

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.01.2016, nëpërmjet vendimit nr. 139, datë 30.12.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil*", Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht, në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 139, datë 30.12.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur të fillojë mbikëqyrjen e përgjithshme, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim, ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion ka përfshirë veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 556 prot., datë 07.09.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 556/1 prot., datë 07.09.2016, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Prefekturën e Qarkut Korçë”*, i është njoftuar institucionit.

Administrata e institucionit të Prefektit ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sipas parashikimeve të nenit 44, pika 1/a. Përfshirja e Administratës së Prefektit në *“Listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1, që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 556/2 prot., datë 31.10.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 556/3 prot., datë 31.10.2016 dhe nr. 556/4 prot., datë 31.10.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, rezulton se, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit, me shkresën nr. 821/2 prot., datë 08.11.2016, *“Dërgohet projektraporti mbi auditimin në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë”*, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 556/5 prot., datë 10.11.2016.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me pasqyrimin e situatës, si dhe me përfundimet e arritura në projektraportin e dërguar për njohje dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave të specifikuara më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës *“Sekretar i Përgjithshëm”*, në institucionin e prefektit të qarkut me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin *“Sekretar i Përgjithshëm”*, në institucionin e prefektit.
3. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në

bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjëset \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- Për punonjësen \*\*\*\*\*: të anulojë aktin nr. 3236/29 prot., datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, të nxjerrë në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile në Korçë”, si dhe aktin nr. 526/21, datë 12.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të nxjerrë në pozicionin e punës, “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë.
  - Për punonjësen \*\*\*\*\*: të anulojë aktin nr. 3236/5 prot., dt. 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, të nxjerrë në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile në Pogradec”, si dhe aktin nr. 526/22, datë 12.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, në pozicionin e punës, “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile, rrethi Pogradec”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Për këtë vendim të njoftohet Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**